



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:085909

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05694571

C.nr.660/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), - Prishtinë-Distrikti në Prizren, kundër të paditurit F. (H) M. nga Prizreni, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 1,116.85 euro, jashtë seancës, me datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET i padituri, që paditësit të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumën prej 1,116.85 euro dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit” **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), pranë kësaj gjykate me datë 05.05.2021, ka parashtruar padi kundër të paditurit F.(H) M. nga Prizreni, i cili ka qenë shfrytëzues i lokalit në adresën me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 1,116.85 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se ekipet kompetente të paditësit me datë 21.05.2015, gjatë kontrolleve të përgjithshme në teren tek i padituri kanë hasur në disa ndryshime në njehsorin elektrik, ndryshime këto të cilat janë bërë pa autorizim nga ana e KEDS, ashtu që konsumatori ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë jo të rregullt, ku kjo energji nuk është regjistruar dhe i njëjti nuk e ka dorëzuar njehsorin elektrik me nr. 657125, andaj me

veprimet e tij i padituri, i ka shkaktuar paditësit dëmin material në vlerë prej 1,116.85 euro, mbi bazën e lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

Paditësi me parashtresën të cilën e ka dorëzuar në gjykatë me datë 14.05.2024, ka theksuar se në bazë të analizës së ekstraktit nga librat afarist të të paditurit, respektivisht për shifrën me numër DPZ 9005232, rezulton se me datë 08.05.2024, është paguar në tërësi borxhi ndaj KEDS sa i përket rikthimit të humbjeve. Po ashtu paditësi me datë 13.05.2024, ka paguar edhe shpenzimet procedurale në shumën prej 30.00 euro dhe atë në emër të taksës për padi. Andaj lidhur me këtë çështje kontestimore e paraqesin këtë parashtresë për tërheqjen e padisë dhe kërkesëpadiës ndaj F.(H)M. pasi që i njëjti ka përmbushur detyrimin për të cilin është paraqitur padia, përfshirë këtu edhe shpenzimet procedurale.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 3 par. 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ku përcaktohet se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi (pajtim) gjyqësorë lidhur me kontestin e tyre”*, si dhe sipas nenit 149, par. 1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, andaj pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 3 par.3.2 dhe neni 149 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:085909, 16.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatah

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit